



BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 11 datë 30. 04. 2014

PËR
“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR ARSYE SHËNDETSORE Z.
OSMAN HAJDARI, KAMPION KOMBËTAR NË SPORTIN E MUNDJES”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10 pika 1 dhe 3/II, neni 32 shkronja ”dh” paragrafi IV, gërma “b” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 31 të ”Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë”; Vendimin nr.1/1 “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2014” me propozim të grupit të këshilltarëve të LSI në Këshillin Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Ti akordojë një ndihmë financiare në shumën 140.000 (njëqind e dyzetë mijë) Lekë, Z.Osman Hajdari, mundës dhe njëkohësisht kampion kombëtar në këtë disiplinë, për të mundësuar kryerjen e një ndërhyrjeje kirurgjikale në këmbë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik të Bashkisë së Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI